# Hebrenjtë në Shqipëri sipas Sigurimit të Shtetit: statistika dhe masa operative

Dokumente arkivore mbi përbërjen numerike, shpërndarjen dhe ndjekjen operative të kontigjentit izraelit nga organet e Sigurisë të Shtetit



Emërtimi i institucionit Degjoria e sig. shtetit
Emërtimi i sektorit Dega e Parë
Viti 1961

DEKLASIFIKUAR
Plotësisht me vendim të KDZH Nr. 27 Datë 4.11.2019
AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

DOSJA Nr. 297/2

Titulli i dosjes

Relacion mbi analizen e kontigjentit izraelite (çifute) që ndodhen me banim në vendin tonë

Afati i ruajtjes Përhershme
Sasia e fletëve 1
Ka filluar më 5.12.1961
Ka mbaruar më 5.12.1961
Numuri rendor 82 i inventarit

Kutia 15
V. 61

AIDSSH
Nr. 67 Prot Date 29.01.2026

SEKSIONI

1944-1950

PERIUDHA

1955 - 1991

Në Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit (27 janar), sjellim në vëmendje dokumente arkivore nga Arkivi i AIDSSH ku pasqyrohet mënyra se si komuniteti hebre në Shqipëri u regjistrua dhe u administrua nga Sigurimi i Shtetit pas Luftës së Dytë Botërore. Fokusi i këtij postimi është te materialet statistikore dhe përshkruese, të cilat paraqesin të dhëna mbi numrin, shpërndarjen gjeografike dhe klasifikimin administrativ të këtij komuniteti. Dosjet i përkasin Fondit të 4-t të Sigurimit të Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme dhe mbulojnë një hark kohor nga viti 1955 deri në vitin 1991. Ato përfshijnë relacione analitike mbi kontigjentin e izraelitëve në Shqipëri, fashikuj lokalë me të dhëna emërore dhe biografike, si dhe dokumentacion mbi procedurat e riatdhesimit dhe largimit përfundimtar drejt Izraelit. Së bashku, këto materiale pasqyrojnë faza të ndryshme të evidentimit, administrimit dhe trajtimit institucional të komunitetit hebre nga organet shtetërore gjatë periudhës socialiste dhe në vitet e tranzicionit.

HEBRENJ IZREAEL HOLOKAUST

PERMBAJTJE #1

# Dokumente arkivore mbi praninë e izraelitëve në Shqipërinë e pa sluftës së II-te Botërore

Materiali që vijon paraqet një përzgjedhje të kufizuar prej 8 faqesh të dokumenteve arkivore të Sigurimit të Shtetit, të cilat trajtojnë praninë e hebrenjve në Shqipëri në vitet pas Luftës së Dytë Botërore. Këto 9 faqe janë përzgjedhur nga një korpus prej 5 (pesë) dosjesh që me gjithësej 889 faqe dhe fokusohen kryesisht te të dhënat statistikore, shpërndarja gjeografike dhe vlerësimet operative të këtij kontigjenti si dhe mbi masat e planifikuara për kontroll dhe monitorim inteligjent. Dokumentet pasqyrojnë qasjen institucionale dhe gjuhën burokratike të kohës, duke ofruar dëshmi të drejtpërdrejta mbi mekanizmat e mbikëqyrjes shtetërore dhe mënyrën se si kjo komunitet u përfshi në strukturat administrative dhe të sigurisë të asaj periudhe.

MEDIA #1

# Relacion mbi analizën e kontigjentit të izraelitëve (cifutëve) që ndodhen me banim në vendin tonë

MEDIA FAQE #1



Emërtimi i institucionit Drejtoria e Sig. Shtetit

Emërtimi i sektorit Dega e Parë

Viti 1961

DEKLASIFIKUAR
Plotësisht me V. ... Date 7.11.2019
KDZH Nr. 27
AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

DOSJA Nr. 297/2 38

Titulli i dosjes

Relacion mbi analizën e kontigjentit izraelite (cifute) që ndodhen me banim në vendin tonë

Afati i ruajtjes Përhershme

Sasia e fletëve 4

Ka filluar më 5.12.1961

Ka mbaruar më 5.12.1961

Numuri rendor 82 i inventarit

Kutia 15
V. 61

AIDSSH
Nr. 67 Prot Date 29.01.2026

Relacion mbi analizën e kontigjentit të izraelitëve (cifutëve) që ndodhen me banim në vendin tonë

MEDIA FAQE #2



INVENTARI I BRENDSHEM I DOSJES

Model Nr. 12

| Nr. | Dokumenti | | Sasia e fletëve | Vërejtje | Nr. | Dokumenti | | Sasia e fletëve | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. | Datë | | | | Nr. | Datë | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 1 | – | – | 1 | | | | | | |
| 2 | – | 5.12.61 | 3 | | | | | | |
| | | | 4 | | | | | | |

AIDSSH
Nr. 67 Prot Date 29.01.2026

Relacion mbi analizën e kontigjentit të izraelitëve (cifutëve) që ndodhen me banim në vendin tonë

MEDIA FAQE #3



REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISE
MINISTRIJA E PUNVE TE BRENDESHME
DREJTORIA E SIGURIMIT TE SHTETIT
D E G A E I-RE
( Seksioni III-te )

TEPER SEKRET
EKZEMPLAR....

Tirane,me 5/XII/1961.

R E L A C I O N:
"MBI ANALIZEN E KONTIGJENTIT TE IZREALITEVE (ÇIFUTEVE) QË NDODHEN ME BANIM NE VENDIN T'ONE:

Nga studimi që u beme disa matrijaleve te vjetra qe ndodheshin ne Seksionin e III-te te Deges I-re per Izrealitet (Çifutet) me banim ne vendin t'one,rezultonte se deri me 1955 (si mbas statistikave) kane qene nje numur prej 237 personash.-

Duke u bazuar se ne keto matrijale,ekspozohej nje veprimtari armiqesore nga radhet e ketij kontigjenti dhe se keta elementa kane shetitur ne shume shtete si para dhe gjate luftes se dyte botnore, ku nga radhet e tyre duhet te jene rekurtuar agjenta nga zbulimet kapitaliste e sidomos nga zbulimi Amerikan,me qellim qe te krijoheshin evidenca te rregullta me personat e kesaj kategorie,te studjoheshin matrijalet qe disponoheshin dhe si mbas situates e interesit operativ te merreshin masat e nevojshme,me urdhrin Nr.08-828 dat 1/7/961 u udhezuan organet e periferise se si te vepronin,ne te njejten kohe te njoftonin me ane relacionesh mbi kete kontigjent dhe veprimtarin armiqesore qe xhvillonin.-

Nga relacionet e ardhura nga organet e periferise lidhur me veprimtarin e ketij kontigjentà dhe gjendjen e tij,dalin keto gjera:

-Ne te gjithe vendin t'one ndodhen me banim 92 Izrealite, nga keta 1 ne 2A dhe 5 ne 2B.Ketu duhet theksuar se kjo shifer nuk eshte e plote,mbasi Durrsi e Tirana,nuk kane njoftuar me statistika se sa kane ne teritorin e tyre,jo vetem kaq,por nuk bejne fjale as per perpunimet qe kane nga radhet e ketij kontigjenti me gjitse ne teritorin e tyre banojne pjesa me e madhe si rrepublik.-

-Te 92 personat(duke perjashtuar Tiranen e Durrsin) jane perqendruar ne keto Rrethe:

1)Ne rrethin e Vlores banojne 78 veta,nga te cilet 3 ne perpunim 2B.-

2)Ne rrethin e Shkodres banojne 6 veta,nga te cilet 1 ne 2A

%

Relacion mbi analizën e kontigjentit të izraelitëve (cifutëve) që ndodhen me banim në vendin tonë

MEDIA FAQE #4


-II-

dhe 1 ne 2B.-

3)Ne rrethin e Sarandes ndodhet me banim 1 person dhe ky ne perpunim 2B.-

4)Ne rrethin e Gjirokastres banojne 5 veta nga te cilet nuk ka asnje ne perpunim.-

5)Ne rrethet Fier dhe Kruje banojne nga nje person,por edhe keta nuk jane ne perpunim.-

Si mbas pergjigjeve ne rrethe te tjera nuk banon asnje person nga radhet e ketij kontigjenti.-

Persa i perket aktivitetit armiqesor qe kane xhvilluar e xhvillojne elementat e ketij kontigjenti,ne relacionet qe dergojne rrethet,theksohet se ky aktivitet,shprehet ne prapagande e agjitacion,ne pakenaqsit e tyre ndaj pushtetit,por konkretisht edhe per kete lloj aktiviteti flet vetem Shkodra per nje perpunim ne 2A.-

Vlen per tu theksuar se relacionet qe kane ardhur nga organet e periferise,jane jashtzakonisht te varfera dhe nuk i eshte bere nje analize e thelle ketij kontigjenti,nuk jane terhequr konkluzione,jo vetem kaq,por siç u permend,Drejtoria e Tiranes dhe Dega e Durrsit -ku banojne shumica e ketij kontigjenti- i pergjigjen urdhrit t'one sa per te kaluar radhen dhe sjapin as statistika,as mbi aktivitetin,as per perpunimet ose ku jane perqendruar keta elementa.-

Duke patur parasysh te gjitha anet negative qe permendem me larte,del se ketij kontigjenti nuk i japin rendesi fare,por i konsiderojne si elementa qe nuk paraqesin asnje interes per te kontrolluar aktivitetin e tyre.-

Për te gjitha keto te meta dhe duke pare rendesin qe kane elementet e ketij kontigjenti,te cilet jane baze e rendesishme e zbulimeve kapitaliste e sidomos e zbulimit Amerikan,nga ana e jone vleresohet si kontigjent me interes operativ per organet t'ona,prandaj propozojme qe te t'ardhmen te merren keto masa:-

1)-Per Drejtorin e Tiranes,Degen e Vlores dhe te Durrsit ku jane perqendruar shumica e ketij kontigjenti,tu shkruhet perseri duke u bere vrejtjet lidhur me te metat e konstatuara si mbas relacioneve te derguara dhe nga ana tjeter te shkohet ne vend dhe te analizohen matrijalet dhe perpunimet e ketij drejtimi.-

2)Te shikohet veprimtarija e ketij kontigjenti dhe ne lidhjet qe kane krijuar me persona qe jane kontigjente te zbulimeve te tjera.-

Relacion mbi analizën e kontigjentit të izraelitëve (cifutëve) që ndodhen me banim në vendin tonë

MEDIA FAQE #5


-III-

3)Te shifet ne Degen e V-te (si mbas listave qe duhet te krijoj periferia) se me cilet shtete mbajne korespondence elementat e ketij kontigjenti nga ku mund te merren te dhena per te perpunuar e zbuluar ndonje kanal spiunazhi.-

4)Per te perpunuar aktivitetin e elementave te ketij kontigjenti,duhet te orjentohet periferia qe te rekurtoje agjenture nga radhet e tyre,per faktin se ky kontigjent ka veçorit e tij,te cilet lidhen si ne shoqeri,krushqi e tj.vetem midis njeri tjetrit.-

5)Te kyhen parasysh kontaktet qe kane krijuar ose do te krijojne me Vizitor,Turista,Delegacione e tj.ku me ane te tyre mund te nderlidhen me zbulimin perkates.-

6)Te porositen organet e Periferise qe ne raportet 6 mujore e vjetore te relatojne ne nje kapitull te veçante per veprimtarin e ketij kontigjenti me qellim qe here mbas here te behet vlersimi aktivitetit te ketij kontigjenti.-

7)Nga studimi më i mirë qe do i behet aktivitetit te ketij kontigjenti,te percaktohen dy ose tre persona me te rendesishme per ti ndjekur me fashikuj kontrolli.-

SHEFI SEKSIONIT III-te

KAPITEN I-re

( Haris Hila )

17-3-1962

Relacion mbi analizën e kontigjentit të izraelitëve (cifutëve) që ndodhen me banim në vendin tonë

MEDIA FAQE #6



27

M I R A T O H E T
ZV.DREJTORI I PUNEVE TE BRENDSHME
DASHAMIR BIMI

" S E K R E T "
Ekzemplár i vetem
Tirane,me 25.11.1986

V E N D I M

PER ARSHIVIMIN E FASHIKULLIT TE ÇIFUTEVE ME BANIM NE QYTETIN E TIRANES

Fashikulli i çifuteve me banim ne qytetin e Tiranes eshte hapur ne vitin 1970 ku jane te evidencuar personat qe jane me kete origjine,te dhena biografike rreth tyre,materiale te kontrollit postar per korespondencen qe kane patur me lidhje te dyshimta jashte shtetit e disa raporte te bp. "Energjiku" e "Rini e lagjes" te vitit 1972.Qysh nga kjo kohe e aktualisht nuk kane dale materiale te tjera ne drejtim te tyre.

Nisur sa siper e ne baze te rregullores se evidences operative Nr.61-41 date 2.5.1985

V E N D O S A

Qe fashikullin e çifuteve me banim ne Tirane ta arshivoj me vlere studimore operative.

PUNETORI OPERATIV
PELLUMB MOÇKA

ZV.KRYETARI DEGES K.ZBULIMIT
GEZIM BEJKO

AIDSSH Nr. 67 Prot Date 29.01.2026

Relacion mbi analizën e kontigjentit të izraelitëve (cifutëve) që ndodhen me banim në vendin tonë

MEDIA FAQE #7



7 (3)

DREJTORIJA E SIGURIMIT SHTETIT
D E G A e II-te

TEPER SEKRET
Tirane me 7/6/1955

R E L A C I O N

L A N D A :- Mbi Izraelitet ne vendin t'one.

Izraelitet ne vendin t'one kane ardhur nje pjese para okupacinit dhe pjesa tjeter gjate okupacionit t'ikur nga vende te ndryshme te Europes dhe Ballkanit nga perzekutimi qe i behej ketyre nga nazistet.

Pjesa qe ka qene me pare ketu merej me tregti duke u-perqendrer me shume ne vende si Vlora, Durrsi dhe Tirana.

Deri ne vitin 1954, nga materialet qe neve kemi, na rezulton se ne Shqiperi ndodhen 237 izraelite, shifer kjo qe nuk mund te konsidrohet krejtsisht e plote dhe mund te kete nonje diference te vogel me pak ose me shume gjate kesaj kohe. Keta jane te ndare si vijon:-

Vlore:---------- 140
Tirane:--------- 83
Gjinokaster:----- 9
Shkoder:--------- 4
Diber:----------- 1
S H U M A:---- 237-

Analiza qe i-eshte-bere kesaj shume ne lidhje me emigrimin e ty ne vendin t'one rezulton ~~texx~~ kene ardhur nga keto vende:-

Nga Greqija:------------ 59 veta.
" Jugosllavija:-------- 3 "
" Çekosllevakija:------ 3 "
" Austrija:------------ 2 "
" Rumanija:------------ 1
S H U M A:------------68

Nga shuma e pergjithshme e tyre ( 237) ne vitin 1954 kane pase nenshtetsine qe vijon:- Greke:--- 47, Jugosllave:---5 dhe te tjeret kan pase nenshtetsine shqiptare.

Gjate vjetit 1954 gati te gjithe kane pase bere kerkesa per te mare nenshtetsine shqiptare si rezultat i tentativave te kota per ri-atdhesim.

Te gjithe kane qene tregtare dhe si rezultat mbas çlirimit kan paguar tatim fitimin e jashtzakonshem, u-jane sekuestruar mallra te ndryshme dhe ka pase dhe shtetzime pasurish te pa-lujtshme.

Sot ne pergjithsi punojne ne sektorin e tregtise sidomos ne sektoret e llogarive per te cilen kane nje aftsi te veçante si kontabel.

QENDRIMI POLITIK I TYRE:- Si te prekur ne pergjisi nuk kane qenrim te mire veçse jane shume te rezervuar per te biseduar poshte e per pjete duke pasur friken e organeve t'ona dhe mos besimin n'elementin shqiptar. Gjithshka behet midis tyre me fanatizme fetare.

Mbas çlirimit nje sasi e konsiderueshme e tyre, ardhur nga vente ndryshme t'Evropes dhe Ballakanit u-riatdhesuan per ne perendim me ane t'UNRRA-s. Pjesa tjeter qe ka mbetur ka bere tentativa te vazhduesh per riatdhesim dhe kete por e vazhdon akoma ne çdo forme.

./...

AIDSSH Nr. 67 Prot Date 29.01.2026

Relacion mbi analizën e kontigjentit të izraelitëve (cifutëve) që ndodhen me banim në vendin tonë

INFORMACION

## Relacion mbi analizën e kontigjentit të izraelitëve (cifutëve) që ndodhen me banim në vendin tonë

Autoret: Sigurimi i Shtetit

| | |
|---|---|
| SASIA E FLETËVE | 6 |
| DOSJA | 297.2 |
| VITI-I KRIJIMIT TË DOKUMENTIT | 1961 |
| VITET EKSTREME | 1961-1986 |
| FONDI | nr. 4 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

# Masa kontrolli për familjaret e një të arrestuari me origjinë hebreje

MEDIA FAQE #1



№ 326 19-5-72 188

15

SHENIM: DEGA E PUNVET TE MBRENDESHME FIER ME SHKR-ESEN NR. 610 DAT 30.VII.1968:-

Kohetee fundit nga ana e kesaj Dege eshte arrestuar [redacted] (Çifut) Familja dhe te afermit e te permendurit banojne ne qytetin e Tiranes:

1)-[redacted] vellai, punon merçolloge ne [redacted]

2)-[redacted], motra dhe buri i saj [redacted], me pune [redacted] Tirane (Merçolloge).

3)-[redacted], Motra e [redacted], martuar me [redacted], rrobaqe-pes ne dyqanin e modes Tirane.

Lutemi merni masa kontrolli ne drejtim te tyre dhe per çdo gje qe do ju dali na informoni, mbasi kemi interes operativ.

Kryetari i Deges Punvet te Bre.
(Muço Sali)

Shenim: [redacted]

Verifikoni sipas vend banimit dhe jepia sektorit perkates Kadri Ismailati. dat 4.8.69.

Puntori Operativ
( Fuat Pushaj)

Masa kontrolli për familjaret e një të arrestuari me origjinë hebreje

INFORMACION

## Masa kontrolli për familjaret e një të arrestuari me origjinë hebreje

| | |
|---|---|
| VITI-I KRIJIMIT TË DOKUMENTIT | 30.07.1968 |
| PUNETORI OPERATIV | Fuat Pushaj |
| DOSJA | 1219 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

# Masat operative për verifikimin dhe ndjekjen e një familjeje me origjinë hebreje

MEDIA FAQE #1



25

\- 2 -

Masa operative.

1) Te bëhet verifikimi i plote ne gjëndjen civile për të përcaktuar me emra gjithe pjestaret e familjes.

2) Te kontrollohen ne kartoteke për te parë se mos kemi materiale apo ndonjeri nga keta eshte b.p.

3) Te bëhet studimi i tyre me qellim qe:

a) Elementet e dyshimtë të evidentohen ne kontigjent, te merren përpunim,etj.

b. te zgjedhim,studjojmë e terheqim ne b.p. nga radhet e tyre .

4) Nje kopje ti dërgohet Deges I-rë për ta vendosur ne dosjen e [redacted],i ardhur vitin e kaluar ne vendin tone.

5) Ti shkruhet Drejtorise III-të për te na sqaruar figuren e [redacted] ne Greqi mbasi ai ka lene te kuptohet se munde te vije perseri ne vendin tone.

Detyra:

B.P. ju dha detyra qe te mbaje kontakte me [redacted],te mesoj ne se presin te vije [redacted],çfare bisedash te tjere jane bërë kur u takuan dhe si reagon ky rreth çifuteve ne Tirane.

PUNTORI OPERATIV
(Kadri Gojashi )

U shtyp ne 2 kopje

Nr. 67 Prot AIDSSH Date 29.01.2026

Masat operative për verifikimin dhe ndjekjen e një familjeje me origjinë hebreje

INFORMACION

## Masat operative për verifikimin dhe ndjekjen e një familjeje me origjinë hebreje

| | |
|---|---|
| DOSJA | 1219 |
| FONDI | 4 |
| VITI-I KRIJIMIT TË DOKUMENTIT | 1976 |
| PUNETORI OPERATIV | Kadri Gojashi |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.